

Fuqizimi i Lidershipit përmes Mentorimit dhe Rrjetëzimit/NDI

Të nderuara dhe të dashura lidere, mentore dhe pjesëmarrëse,

Të nderuar përfaqësues të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Institutit Kombëtar Demokratik (NDI)”.

Është një kënaqësi dhe përgjegjësi e veçantë të jem sot me ju, në këtë ngjarje që shënon lansimin e edicionit të gjashtë të Programit të Mentorimit për Lidership. Por ky nuk është thjesht një fillim I një program, është një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të një shoqërie më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe më demokratike.

Të gjithë ne e dimë se rruga e grave drejt lidershipit publik nuk ka qenë dhe ende nuk është e lehtë. Ajo është e mbushur me pengesa strukturore, kulturore dhe institucionale që shpesh nuk duken, por ndihen: në vendimmarrje, në përfaqësim, në mundësi dhe në besim. Të flas sot para jush si Kryetare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, dhe si gruaja e parë që mban këtë pozitë, është një moment jo për të treguar një arritje, por për të treguar një rrugëtim. Një rrugëtim, që si çdo rrugëtim profesional, nuk ka qenë as i drejtpërdrejtë dhe as i lehtë. Ky rrugëtim nuk është unik për mua; ai pasqyron përvojat e shumë grave, pavarësisht sektorit ku veprojnë – në akademi, në institucione, në biznes, në shoqëri civile apo në komunitet.

Dua ta them qartë që në fillim, e gjithë ajo që kam arritur nuk është rezultat i një rruge të vetmuar. Pas çdo hapi të rëndësishëm në karrierën time akademike dhe profesionale kanë qëndruar njerëz (së pari familja) e pastaj mentore dhe mentorë, që më kanë udhëzuar, më kanë sfiduar, më kanë mbështetur dhe, në shumë raste, më kanë ndihmuar të vazhdoj edhe atëherë kur dyshimi ishte më i madh se siguria, e kjo përvojë lidhet më shumë me përvojën politike. Ky është një rikujtim i rëndë. Një tjetër mësim i rëndësishëm nga përvoja ime është se lidershipi nuk ndërtohet vetëm mbi individualizëm, ai ndërtohet mbi rrjete. As shkenca, as politika, as institucionet nuk funksionojnë në izolim. Idetë zhvillohen përmes dialogut, Vendimet përmirësohen përmes bashkëpunimit dhe Ndikimi rritet përmes aleancave.

Një nga këto pengesa të heshtura, por që janë mjaft të fuqishme, është mungesa e rrjeteve të mbështetura – ato lidhje profesionale dhe njerëzore që shpesh bëjnë dallimin mes një ideje që mbetet në letër dhe një ideje që shndërrohet në ndikim real.

Prandaj sot nuk jemi këtu vetëm për të shënuar fillimin e një programi. Jemi këtu për të afirmuar një filozofi lidershipi që nënkupton: askush nuk ngrihet vetëm, individual ndërtohet mbi solidaritet kolektiv dhe rrjetëzimi mes grave nuk është luks – është domosdoshmëri demokratike.

Programi i Mentorimit për Lidership e përfshin këtë filozofi. Programi nuk krijon vetëm marrëdhënie mes një mentorë je dhe një kandidati. Ai krijon ura besimi, hap dyer për mundësi të reja, forcon vetëbesimin dhe ndërton kapital social – atë kapital që shpesh i mungon grave në politikë dhe në jetën publike. Përmes mentorimit, përvoja shndërrohet në trashëgimi, dija në ndikim dhe ambicia personale në mision kolektiv.

Kjo marrëdhënie e ndërsjellët është themeli i lidershipit transformues: një lidership që nuk mbështetet në hierarki, por në bashkëpunim; jo në autoritet të imponuar, por në besim të ndërtuar. Në këtë hapësirë rrjetëzimi, kemi ndërthurje sektorësh, përfaqësuar politika, shoqëria civile, media, biznesi dhe akademi, e cila në fakt paraqet strategji kombëtare. Sfida e grave dhe shoqërisë sonë është komplekse, dhe përgjigjet ndaj saj kërkojnë bashkëpunim ndër sektorial, dialog të hapur dhe aleanca të qëndrueshme. Vetëm duke u lidhur përtej kufijve institucionale dhe profesionale mund

të ndërtojmë institucione më të përgjegjshme, politika më gjithëpërfshirëse dhe demokraci më funksionale.

Dua të shpreh mirënjohje të veçantë për përfaqësuesen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Institutit Kombëtar Demokratik (NDI)”, për përkushtimin e tyre në fuqizimin e lidershit të grave. Këto partneritete janë më shumë se mbështetje programore ato janë investime në demokraci, barazi dhe të ardhmen tonë të përbashkët. Përmes punës suaj, mentorimi shndërrohet në mjet konkret të ndryshimit strukturor dhe rrjetëzimi I grave dhe liderëve në strategji për transformim shoqëror.

Të dashura pjesëmarrëse

Ju ftoj që këtë program ta shihni jo vetëm si mundësi zhvillimi individual, por si përgjegjësi kolektive: (i)Të jeni jo vetëm përfituese të mentorimit, por edhe bartëse të , (ii) ndërtoni marrëdhënie që zgjasin përtej këtij edicioni, të ndani dije, të hapni dyer për njëra-tjetrën,(iii)Të ngritni zërin për ato që ende nuk janë dëgjuar dhe(iv) të qëndroni së bashku kur s fidat duken më të mëdha se mundësitë.

Sepse lidershipi i grave nuk është vetëm çështje numrash – është çështje cilësie demokratike, drejtësi sociale dhe përfaqësim real. Rrjetet e grave janë më shumë se shkëmbim kontaktesh – ato janë ndërtim besimi dhe force kolektive.

Solidariteti ndërmjet grave nuk do të thotë pajtim i domosdoshëm, por të shohim suksesin e njëra-tjetrës si mundësi, të përkrahemi dhe të mbrojmë njëra-tjetrën në hapësira ku shpesh përfaqësim nuk është I mjaftueshëm. Si gruaja e parë në krye të Akademisë, e shoh këtë rol si përgjegjësi për të hapur rrugë për të tjera. Arritjet personale duhet ti vlerësojmë, por ato kanë kuptim vetëm kur shndërrohen në mundësi kolektive.

Të nderuara vajza dhe gra, mos keni frikë të kërkonin ndihmë, këshillë dhe mbështetje. Lidershipi nuk është të dish gjithçka, por të dish nga kush të mësosh. Mentore të dashura, ndikimi juaj shkon shumë përtej një marrëdhënieje individuale. Përvojat tuaja dhe dija profesionale, Përkrahja e juaja individuale e sinqerta dhe shpërndarja e energjisë pozitive, si dhe këshillat në orientimet e profileve ka ndikuar dhe do të ndikoj në ngritjen e vetëbesimit dhe guximit. Kjo qasje, nuk është më mësim, por strategji dhe perspektivë për një shoqëri të avancuar, moderne dhe demokratike.

E përmbyll me këtë mesazh: Lidershipi me ndikim ndërtohet mbi marrëdhënie, besim dhe guxim për të ecur së bashku. Le ta shndërrojmë solidaritetin tonë në forcë që sjell ndryshim për të gjitha.

Edhe njëherë shumë urime për këtë projekt dhe organizim sot. Një falënderim të përzemërt zonjave Nancy Soderberg dhe zonjën Beate Katja. Dhe në fund ju dhurojë një kujtim nga Akademia, duke ju ftuar që në të ardhmen të planifikoni një organizim të përbashkët në Akademi. Ju faleminderit dhe ju uroj suksese në këtë rrugëtim të përbashkët.

Akademike Justina Shiroka-Pula

Prishtinë, 12.02.26